



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 214, Datë 28.12.2017

MBI

**MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE MARRËVESHJES SË PJESËMARRJES NË BURSËN
SHQIPTARE TË ENERGJISË”**

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “a” dhe 98 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike, në lidhje me miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në Bursës Shqiptare të Energjisë,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 1, datë 19.01.2017, filloi procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursës Shqiptare të Energjisë”.
- ERE me shkresën nr. 100/8 Prot., datë 27.01.2017, publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit, duke filluar nga data 28 Janar 2017. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.
- Me shkresën nr. 88 Prot., në datë 26.01.2017, ERE dërgoi draft – Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursës Shqiptare të Energjisë, për marrje mendimi, pranë subjekteve: OSHEE sh.a., KESH sh.a., MEI, Autoriteti i Konkurrencës, AAES, Shoqata e Prodhuesve të Vegjël të Energjisë Elektrike, FIAA si dhe AREA.



- Pas përfundimit të afatit 15 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 30/1 Prot., datë 23.02.2017 dhe OSHEE sh.a. me shkresën nr. 2744/1 Prot., datë 10.02.2017.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të miratojë Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursës Shqiptare të Energjisë”.
2. Këto Rregulla do të hyjnë në fuqi me bërjen të zbatueshm të Modelit të Tregut, në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë, siç parashikuar në pikën 8, të VKM-së 519, datë 13.07.2016.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit AHMETI

https://ere.gov.al/doc/Rregullat_e_Tregut_Shqiptare_te_Energjise_Elektrike_-1.pdf